

... “metamorfoza”, “metaforat e tingujve”, “refleksione dhjetvjeçare”, “këmbanat e heshtjes”, “lutje për shpirtrat e trazuar”, “romancë”, “in-tenebris”... flisnim, flisnim dhe pinim duhan pa fund.

...

Atë ditë të ftohtë dimri, tek bar “Artisti”, e filluam atë bisedë me tone të qeta e plot “edukatë” dhe e pasuam me ndërprerje fjale njeri -tjetrit, plot klithma pasioni e thirrje jashtë “norme” për dy profesorë akademie. Dhe ishte normale.

Po pagëzohej një vepër. Po pagëzohej dhjetë vjet jetë. “ IN-TENEBRIS”. Nuk ishte thjeshtë një akt bashkëpunimi, por një akt njohjeje.

Po njiheshin nga afër dy njerëz. Dy njerëz që vite e vite me radhë kishin përshëndetur njeri-tjetrin në rrugën e madhe.

”Të përshendesja, thjeshtë e me respekt dhe kurrë nuk e kisha kuptuar se po të dhunoja një çast të shenjtë, duke të shkëputur nga stuhija e tingujve që të zhurmonin në kokë”.Atë ditë dimri të ftohtë akull, kuptova së fundi se sa ngrohtë ishte në qenien tënde.

...

“IN-TENEBRIS”... dhe u gezova që fitova një mik.

GAZMEND LEKA

Ky tekst është shkruar në katalogun “IN-TENEBRIS” të kompozitorit Shpetim Kushta.